



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 17.04.2015, me fillim në ora 10.15. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Nahit Elshani**.

Kryesuesi Elshani – Fillimisht më lejoni të përshëndes Nënkryetarin e komunës z. Xhemali Haxhimustafa, Përfaqësuesit e zyrës ligjore, delegatët e pranishëm në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-dhe të KFOR-it, përfaqësuesit e mediave dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Ju paraqes rendin e ditës të paraparë për këtë mbledhje:

Rend dite

1. **Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Shqyrtimi i draft Rregullores për dhënien e lejeve mjedisore komunale ,**
3. **Shqyrtimi i projekt vendimit për shlyerjen e borxheve 50% për shfrytëzimin e pronës komunale (dyqane),**
4. **Shqyrtimi i kërkesës së banorëve të fshatit Xërxë,**
5. **Propozim për shpalljen e interesit publik për ngritjen e objektit për zjarrfikësit ,**
6. **Të Ndryshme.**

Kryesuesi – E qesë në aprovimin e rendit të ditës me një pikë shtesë, konstatoj se rendi i ditës është aprovuar në mënyrë unanime. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës?

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Aprovohet pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i draft Rregullores për dhënien e lejeve mjedisore komunale.

Fehmi Hoxha, Drejtori i Urbanizmit – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Rregullorja për dhënien e lejeve mjedisore komunale është si rezultat i ligjit i planifikimit hapësinor dhe ka qenë e domosdoshme të hartohet një rregullore e tillë pas miratimit të rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba ku kanë pësuar ndryshime këto taksa në bazë të grupeve të ndara të bizneseve, këtë rregullore e ka hartuar zyra ligjore.

Isak Hoti, Shef i zyrës ligjore – Rregullorja për leje mjedisore ka pasur disa ndryshime sepse me hyrjen në fuqi të rregullores për taks, tarifa dhe gjoba ka lindë nevoja që të bëhet një rregullore e re për dhënien e lejeve mjedisore komunale, sepse neni 29 i rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba me nr 01 1076 e datës 27.03.2015 e shfuqizon në tërësi rregulloren e mëhershme për dhënien e lejeve mjedisore komunale me nr 18 49 të datës 12.03.2013. Qëllimi i kësaj rregullore është parandalimi i ndikimit negativ në mjedis që mundet të shkaktohet nga subjektet publike apo private me rastin e realizimit të veprimtarive apo projekteve të cilat munden të shkaktojnë çrregullime në mjedise, rregullorja në fjalë përcakton rregulla dhe procedura për identifikimin, vlerësimin dhe raportimin e ndikimit në mjedis dhe procedurat administrative gjatë procesit të vendimmarrjes nga autoritetet komunale për lëshimin e lejeve mjedisore. Rregulloja i ka gjithsej 27 nene dhe shtojcën me listën e aktiviteteve të bizneseve të specifikuara sipas veprimtarive që i nënshtrohen pagesës me rastin e marrjes së lejes mjedisore që është e ndarë në 6 grupe, në këto 27 nene janë të përfshirë: Qëllimi, përkufizimi, autoritet kompetente, aplikimi, paraqitja e kërkesës, përmbajtja e raportit për marrjen e lejes mjedisore komunale, përpilimi i raportit për marrjen e lejes komunale, komisioni profesional për vlerësimin e raportit të ndikimit në mjedis, afati për miratimin e të drejtës së ankesës, transferimi i lejes mjedisore komunale, ndërprerje e vlefshmërisë së vendimit për LMK, vazhdimi i afatit të LMK- së, regjistri i lejeve komunale, dispozitat ndëshkuese, dispozitat kalimtare dhe dispozitat përfundimtare dhe zgjidhja e kontesteve. Në raste kontesteve dhe në raste të shkaktimit të dëmeve eventuale të dëmtimit në mjedis kompetentë për vendosjen është gjygsori gjegjësisht gjykata themelore në Gjakovë nëndega në Rahovec që është e paraparë edhe në nenin 24 të kësaj rregullore, për aplikimin e lejes mjedisore komunale duhet të mirët së pari leja për ndërtim këtë e përcakton edhe udhëzimi administrativë 10/ 2012 i LMK-së.

Florije Boshnjaku – Në lidhje me këtë rregullore për mjedis tek dispozitat e përgjithshme tek neni 1 ku thotë se qëllimi i kësaj rregullore është parandalimi ose zvogëlimi, unë mendoj se duhet të na jepet një sqarim tek subjektet publike dhe private sepse nuk e kamë të qartë se çka thuhet. Tek përkufizimet tek neni 2 është 1.4, drejtorja për urbanizëm planifikim dhe mbrojtje të mjedisit shkurtesa është DUMM mos e keni harruar ndonjë shkronjë. Leja mjedisore komunale deri sa këtu i keni shkurtuar shkurtesat pse tash keni ardhur tek neni 1.7 ku thuhet LMK pse nuk është shënuar tek këto shkurtesat. Ku është bazuar drejtorja juaj kur thotë raporti a jeni bazuar në ligje apo në udhëzime administrativ, pastaj komisioni profesional komunal tek neni 2 pika 1.9 ky

komision a vendosë a i propozon drejtorisë, kryetarit apo kush vendosë për lejimin e kësaj leje, pra nuk është e qartë se kush e bie këtë vendim. Tek kërkesa dhe procedura për aplikim tek neni 5, shërbimi administrativë duhet të jetë një zyrtar pranë kësaj drejtorie i cili i kompletton dhe verifikon dokumentet dhe pastaj ia dorëzane komisionit. Tek neni 6 pika 1.2 nuk e kamë të qartë se çka është pajimet. Tek raporti që i dorëzohet drejtorisë ku thuhet se janë tre anëtarë të komisionit a janë me afat të caktuar apo me afat të pacaktuar. Këto objekte afariste që ekzistojnë si subjekte afaristë 90 ditë prej ditës së miratimit të kësaj rregullore janë të obliguar që të pajisen me këtë laje mjedisore komunale. Neni 12 transferimi i lejes mjedisore komunale pika 5 ku thotë se komisioni parasheh shkaqet e mos transferimit të lejes mjedisore komunale janë borxhet komunale e tjera, nuk duhet të thuhet e tjera sepse kjo është rregullore kjo është akt normativë. Neni 14 ku thotë vazhdimi i afateve mjedisore komunale, kur pala subjekti fizikë ose juridikë vije që të vazhdojë këtë leje a duhet të bëjë pagesën prej fillimi apo ka diçka që mundet ta lirojë. Tek neni 17 dispozitat ndëshkuese ku thuhet se gjoba në të hodha prej 5.000 € deri 10.000 € gjobitet për kundërvajtje personi juridikë dhe personi fizikë, ku jeni bazuar për këtë. Po ashtu e kam edhe një pyetje tek shtojca p.sh në grupin e 3 deri në 150 € duhet të paguajnë për marrjen e lejes mjedisore komunale, nëse i ka dikush 200 bagëti paguan 150 € por nëse i ka 210 bagëti sa duhet të paguaj, pra duhet të specifikohet se deri në 200 është kompetente komuna po te këtë 201 është kompetente ministria përkatëse.

Selim Duraku – Desha të ndërlidhem tek mjedisi sepse ju e keni përkufizuar se mjedisi është: Ajri, uji, klima, flora, fauna dhe trashëgimia kulturore, nëse marrim fjalën mjedis ajo ka një rrethë shumë më të gjerë sepse ka edhe mjedisë ekonomikë, bujqësorë, financiar etj. Tek neni 2 përkufizimet shohim se në komunën tonë mirën shumë leje të ndërtimit në fushat pjellore këto leje e dëmtojnë mjedisin bujqësorë, sepse diku rreth 80 leje janë dhënë vetëm në komunën tonë.

Fatmir Iska – E kam lexuar rregulloren dhe është për të ardhur keq rreth formës së sajë, në këtë rregullore përpos gabimeve gjuhësore që mundet të ketë por ma e keqja është se janë bërë copi pastë të gjitha nenet dhe po ashtu është e njëjta rregullore si e komunës së Klinës vetëm ka disa përmasime ku thuhet e cila të cilët, duke qenë kështu ne çka kemi me biseduar ma shumë rreth kësaj rregullore. Përmenden këtu ligjet udhëzimet administrative të MPH. Tek neni 9 afati për miratim pika 2 ku thotë se subjektet afariste ekzistuese që nuk janë të pajisura me leje mjedisore komunale e kanë obligim të pajisen me LMK sipas kësaj rregullore dhe udhëzimit administrativë obligohen që në afat prej 90 ditësh të bëjnë kërkesë për pajisje me leje mjedisore dhe ti nënshtrohen procedurave të kësaj rregullore. Unë e kam një pyetje se çka do të bëhet në raste se subjekti ekzistues nuk i plotësonte kushtin për me mare lejen mjedisore komunale a do të bëhet mbyllja e këtij subjekti ose çka do të ndermirët. Tek neni 9 ku thotë në raste të aksidentit në procesin teknologjikë pajisjet të subjektit afaristë që munden të shkaktojnë rrezik të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për mjedisin e dhe shëndetin e njeriut. Komuna inspektori i mjedisit e shpallë gjendjen e mjedisit të rrezikuar ndërsa personi i juridikë dhe fizikë menjëherë të ndërmerr masa të sanimit sipas raportit të lejes mjedisore komunale, unë mendoj se duhet të evidentohet përgjegjësia e shpenzimeve se kush i bartë këto shpenzime a i bartë komuna apo subjekti afaristë. Tek dispozitat e fundit kalimtare dhe përfundimtare, duhet të jetë përfundimtare dhe kalimtare. Tek neni 25 në raste të kundërtënieve të dispozitave të kësaj rregullore me ligjin për vetëqeverisje lokale apo ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedisin apo akteve tjera të pushtetit qendrorë si dhe në rast të zbrazëtirave të tjera juridike në këtë rregullore drejtpërsëdrejti vlejné depozitat e ligjit për vetëqeverisje lokale, unë mendoj se këtu nuk vlejné dispozitat e vetëqeverisjes lokale. Unë mendoj se e gjitha kjo ka mundur të përshkruhet vetëm me një resht ku mundë të thuhet në rast të kolizionit ose t dispozitave të kësaj rregullore vlen ligji i cili është bazë që e rregullon. Unë them nëse mirët diçka le të mirët me pika dhe presja të njëjtë dhe mos të hiqet dhe as të shtohet asgjë, për arsye se kjo rregullore duhet të jetë e njëjtë për gjitha komunat sepse nuk ka ndonjë specifike që mundet me i rregulluar komunat tjera veç e veç.

Kryesuesi – Tek neni 18 pika 2 mos është dallimi shumë i madh me gjobë prej 500 € deri në 5.000 €.

Isak Hoti – Tek neni 18 pika 2 vlerat janë të përcaktuar në udhëzim administrativ dhe nuk mundemi të ikim prej saj. Sa i përket parafolësit tek çështja e copit pastë unë mundem ta falënderoj për çështjet ku i ka dhënë rreth asaj se ku duhet të ndryshohet ose plotësohet dhe pajtohem plotësisht, ndërsa sa i përket pjesës tjetër është mirë të lexohet udhëzimi administrativ 10/2012 edhe me dashtë që nga qëllimi e deri tek përkufizimi është gjithçka në udhëzim administrativ se çka është GLN-ja dhe çka është ministria, çka është leja mjedisore komunale, komuna të gjitha pra janë të parapara në udhëzimin administrativ. Autoriteti kompetent nuk e kemi shpik ne se nuk mundemi, të jenë edhe 50 komuna të tjera nuk guxojnë ndryshe të cekin pra të gjitha komunat e kanë të njëjtat emërtime. Tek aplikimi dhe paraqitja e kërkesës ne nuk mundemi me dal dhe me shpikë diçka sepse është e paraparë në udhëzimin administrativ. Përmbajtja e raportit të LMK-së është njëjtë në udhëzimin administrativ edhe njëjtë e kemi bërë përshkrimin. Përpiluesi i raportit është njëjtë tek udhëzimi administrativ dhe njëjtë në rregullore, të gjitha komunat do ta kenë të njëjtë sepse nuk mundet ndryshe por ne jemi munduar që të ju përshtatemi specifikave të komunës sonë, pe mare një shembull nëse Prishtina e ka për leje mjedisore në grupin

e 6 është 200 € ne si komunë e kemi 50 €. Fatmirë mere lexoje rregulloren në kohën kur keni qenë ju në pushtet ku është e njëjta rregullore ne nuk kemi dal jashtë asaj, çka ka qenë gabimi kësaj rregullore që na ka nxjerrë probleme shumë të mëdha është se në 2013 nuk e kemi paraparë se në rastë kontesti kush është kompetent për zgjidhjen e kontesteve, pra gjykatën themelore dhe si rezultat i kësaj na ka prurë këtu.

Fatmir Iska – po më duket se jemi keqkuptuar se unë e thashë rregullorja si e tillë duhet të jetë unike në tërë komunën përpos atyre taksave që munden të jenë varësisht prej asaj se a është qendër apo ndonjë qytezë dhe unë nuk e kam thanë që të dalim jashtë kornizave ligjore dhe udhëzimeve administrative dhe të bëhet diçka tjetër. Është normalë se kur bëhet një rregullore të mirët udhëzimi administrativë ose ligji si bazë por jo kompletë si është ligji nëse është ashtu atëherë e kemi ligjin dhe nuk kemi nevojë për rregullore.

Nënkryetari – Znj. Florije e tha me të drejtë por është një digresion që e bëri në nenin 1 tek publike dhe private dhe ke dileme se a janë personat fizikë apo juridikë, pra këtu duhet të jetë kështu: Për subjektet afariste me subjektivitet publikë dhe subjektivitet privatë, pra vetëm kjo duhet të shtohet. Ndërsa sa i përket nenit 2 pika 1.9 ku thuhet komisioni profesional komunal është autoritet i cili bënë vlerësimin e raportit të ndikimit në mjedisë dhe i cili është i obliguar që të jepe mendim për miratimin apo refuzimin e dhënies së lejes mjedisore komunale, pastaj neni 3 thotë: Autoriteti kompetent për zhvillimin e procedurës dhe për lëshimin e lejes mjedisore komunale është komuna përkatësisht drejtoria për urbanizëm, planifikim dhe mbrojtje të mjedisit, pra kjo e sqaron se kush është organi i fundit që e lëshon lejen. Po ashtu neni 9 thotë se në afat prej 30 ditëve komisioni profesional ka afat të bëjë analizën profesionale të kërkesës dhe në afat ai do ta jepe mendimin me shkrimë se a plotësohen apo jo kushtet dhe automatikisht drita e gjelbër organit i cili ka me leshu atë leje.

Kryesuesi – Kush është për të kaluar në kuvend kjo pikë me këto rekomandime që u dhanë? Në mënyrë unanime është aprovuar kjo pikë e rendit të ditës, kalojmë në pikën e radhës.

3. Shqyrtimi i projekt vendimit për shlyerjen e borxheve 50% për shfrytëzimin e pronës komunale (dyqane),

Avdullah Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ky material ka qenë edhe në komitetin e kaluar dhe ne mbledhjen e kaluar ju keni dhanë rekomandime edhe në KPF edhe në kuvend dhe sipas rekomandimeve tuaja është prurë ky vendim nga ana e kryetarit të komunës për shlyerjen prej 50% të borxhëve bizneseve që gjinden në rrugën Xhelal Hajda – Toni dhe Avdullah Bugari në Rahovec, pra vetëm për lokalet e mbyllura, e keni marrë listën e lokaleve për të cilat propozohet shlyerja e borxheve prej 50% dhe nëse ka ndokush ndonjë rekomandim ne jemi këtu për të ju dëgjuar.

Florije Boshnjaku – Kam një pyetje tek neni 3 i vendimit ku thuhet: Obligohen të gjithë shfrytëzuesit e lokaleve afariste dhe që janë pronë e komunës që të paguajnë paraprakisht 50 % të borxhit me qëllim të shlyerjes së pjesës së mbetur në afat kohorë prej 3 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, unë e pyes drejtorin nëse ne ja japim lokalin pronarëve dhe ata brenda 3 muajve nuk i paguajnë borxhin çka do të ndermirë komuna në këtë rast, është mirë që të shtohet edhe një nenë që nëse ata brenda 3 muajve nuk munden ta paguajnë borxhin obligohet komuna që të shkëputë kontratë me ta.

Kryesuesi – Tek pika 3 drejtor ku thuhet të gjithë shfrytëzuesit e lokaleve afariste (dyqanet) mendoj se duhet të shtohet edhe një fjala borxhlinjtë, pra të jetë kështu për të gjithë shfrytëzuesit e lokaleve afariste- borxhlinj dhe që janë pronë e komunës. Po ashtu është mirë që ti shtohet një nen i veçantë këtij propozimi ku të gjithë shfrytëzuesit e lokaleve afariste komunale të cilët kanë qenë pagues të rregullt të qirasë të lirohen për vitin 2015 nga qiraja, unë mendoj se është padrejtësi që nëse dikush e paguar rregullisht qiranë e mos të shpërblehet, ndërsa këta që kanë qenë pagues jo të rregullt të stimulohen me shlyerje të borxheve prej 50%. Kam edhe një propozim për dy bizneset si Oratoria dhe rrobaqepësi që kanë mbetur në Rahovec të vetme që të i ulët qiraja. E qesë në aprovime këtë pikë të rendit të ditës me këto plotësime? Me 1 abstenim dhe tjerë pro është aprovuar pika e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i kërkesës së banorëve të fshatit Xërxë. Kryesuesi - është një reagim i banorëve të fshatit Xërxë ku rreth 50 persona kanë nënshkruar ata nuk janë kundër hidrocentralit por janë kundër mënyrës se si është proceduar me dhënie të pëlqimit nga ana e drejtorisë për urbanizëm dhe këta banorë kërkojnë që ky hidrocentrale të ndërtohet ma poshtë. Unë e kam lexuar edhe ligjin për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim dhe me hyrjen në fuqi të këtij ligji komuna nuk ka të drejtë të jepe pronë komunale pa e shpallë atë pronë për interes të përgjithshëm për një veprimtari të caktuar, dhe ne si komunë këtë nuk e kemi bërë, nëse komuna ka interes me pas një hidrocentrale në lumin Drini i Bardhë atëherë ne si kuvendë duhet me propozim të kryetarit me e shpallë interes të përgjithshëm një pjesë të Drinit të Bardhë ku munden të operojnë hidrocentralet, pastaj janë procedurat tjera për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale e cila bëhet me anë të ankandit publikë. Ne sot si kuvend duhet të marrim një vendim për tërheqjen e pëlqimit të cilin e ka dhanë drejtoria për urbanizëm.

Fehmi Hoxha – Në aspektin ligjorë dhe procedural për disa lëshime dhe pëlqime që janë dhënë ma herët, unë dy herë një njoftim dhe një konkluzë ja kam dërguar kërkuessit, njoftimi i fundit të cilin ja kam dërguar kërkuessit

dërguar konkluzën e datës 12.01.2015 ku njëra pikë ka qenë mbajtja e diskutimit publikë me banorët e rrethinës për sqarimin e projektit dhe ndikimin e projektit në rrethin dhe mjedisin, mirëpo deri më tani nuk ka pas kurrfarë lëvizje rreth kësaj, ndërsa me datë 03.02.2015 në drejtori ka mbërritur një reagim i qytetarëve. Do të kthehem pak mbrapa me 27.11.2012 drejtorja e urbanizmit ja ka lëshuar kërkesit një pëlqim në parim, unë do ju lexojë këtë pëlqim: Drejtorja për urbanizëm, planifikim dhe mbrojtje të mjedisit duke u bazuar në rregullativat në fuqi dhe të orientuar në krijimin e kushteve në zhvillimin e veprimtarisë ekonomike pajtohet në parim që kompania Delveis Energi sh.p.k në Prishtinë me përfaqësues ligjorë Ismet Kelmendi të ndërmerr veprime procedurale rreth rregullimit të dokumentacionit investiv për ndërtimin e hidrocentralit UC tek Ura e Fshejtë në komunën e Rahovecit me kapacitet 6.5 megavat në njësi ngastra me numër të caktuar vendi i quajtur Drini i Bardhë – Rakita të lëshuar me 20.11.2012. kjo drejtori konsideron se ky projekte i planifikuar i kompanisë në fjalë nuk paraqet ndonjë pengesë për planin zhvillimorë urban të komunës së Rahovecit. Të nderuar anëtarë të KPF komuna e Rahovecit nuk ka pas kurë planin zhvillimorë urbanë as që e ka as sot, dhe ky pëlqim është lëshuar pa bazë duke u bazuar në planin zhvillimorë urban që është inegzistent për komunën e Rahovecit, po ashtu nuk kanë mundur të bazohen as në planin zhvillimorë komunal sepse plani zhvillimorë komunal diku në vitin 2013 është lëshuar, prandaj unë kërkoj nga ju që ky venim të shfuqizohet dhe të jepni një vendim për seancën e radhës sepse ky vendim është i kundërligjshëm. Po ashtu përfaqësuesi i kompanisë e ka sjellë një dokumente që është i publikuar në bazë të ligjit të një debati publikë që është i publikuar në gazetën Kosova Sot me 27.08.2012, pra debati publikë është mbajtur ende pa e marrë pëlqimin në parim i cili si dokument juridikë nuk ekziston. Zotëria në fjalë është pajisur me të gjitha dokumentet në bazë të ligjit që kërkohet nga Ministria mjedisit, departamenti i ujërave. Ne e kemi shumë të qartë që Kosova ka nevojë që të krijojë energji alternative 30% mirëpo ne duhet ti zhvillojmë procedurat juridike ashtu si edhe tha kryesuesi që kuvendi duhet ta përcaktoj një parcelë dhe të shpallë interes të përgjithshëm për ndërtimin e ndonjë hidrocentrali në të ardhmen.

Rasim Fazliu – Ne edhe herrave tjera kemi biseduar për këtë çështje, por unë befasohem sepse asnjëherë nuk kemi pas informatë të saktë rreth kësaj çështje, ne si kuvend duhet të jemi të informuar në mënyrë të detajuar dhe të jemi të përgatitu dhe të informuar edhe në qoftë se na pyet ndonjë qytetar se çka është duke u ndërtuar të dimë ti përgjigjemi. Kisha pas dëshirë që së paku tani e tutje të jemi të informuar saktësisht për çdo gjë që është duke ndodhur aty. Ndërsa sa i përket ambientit është mirë edhe për atë të mendohet sepse ne e dimë se është mirë të ndërtohet hidrocentrali por duhet të mendojmë për banorët e komunës së Rahovecit për rekreacionet e shumta që i zhvillojnë në atë pjesë.

Flori Boshnjaku – E kam parë reagimin e banorëve të fshatit Xërxë dhe unë besoj se as ata dhe as ne nuk jemi kundër investitorëve të huaj, ne jemi për investime por deri në atë pikë sa nuk dëmtohet të tjerët, këtu janë dy çështje që janë duke u ngritur përmes këtij reagimi të banorëve të fshatit Xërxë, njëra anë është drejtorja që na njoftojë në lidhje me pëlqimin që na është dhënë dhe ne si kuvend nuk mundemi me e shfuqizuar atë pëlqim, pëlqimin e shfuqizon drejtori i drejtorisë përkatëse ose kryetari i komunës varet se kush e jep pëlqimin, dhe tjetra banorët nuk janë kundër hidrocentralit por ata po kërkojnë që të zbritet ma poshtë. Unë propozoj që të mbahet një takim në mes të kryetarit, banorët e fshatit dhe donatori gjithmonë thirrëm në atë nëse nuk shfuqizohet pëlqimi dhe të dilet me një propozim konkret se a mundet ky hidrocentral të shkojë pak ma poshtë nëse nuk e dëmton.

Kryesuesi – Drejtorja përkatëse duhet ta tërheq pëlqimin sepse pëlqimi bie ndesh me ligjin, po ashtu në petition janë edhe dy fshatra të tjerë që kanë reaguar por që nuk janë nënshkruar sepse me ndërtimin e këtij hidrocentrali do të bëhet çrregullimi i ambientit.

Fehmi Hoxha – Rreth pëlqimit në parim pse unë kërkoja që ju të merrni një vendim, afatet ligjore janë kur aplikon aplikuesi brenda 30 ditëve ne si drejtori duhet të ja kthejmë përgjigjen qoftë pozitive qoftë negative, në këtë rast palës i është dhënë pëlqimi në parim dhe ky pëlqim mundet të tërhiqet po ashtu brenda 30 ditëve, ndërsa ajo është marrë në 2012 ndërsa ne jemi në 2015, pra tash ne nuk kemi të drejtë si drejtori ta tërheqim vendimin dhe për atë arsye unë e paraqita në kuvend.

Kryesuesi – Nëse pajtoheni e kalojmë këtë pikë të rendit të ditës për kuvend. Pika e radhës është:

5. Propozim për shpalljen e interesit publik për ngritjen e objektit për zjarrfikësit.

Kujtim Popaj – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, kemi të bëjmë me shpalljen e interesit publikë të një prone komunale me sipërfaqe 67 ari e 10m2 që gjendet në vendin e quajtur krahishite, arsyeshmëria e shpalljes së kësaj prone është sepse qeveria ka planifikuar që në këtë pronë të ndërtohet stacioni i zjarrfikësve.

Flori Boshnjaku – Propozoj që ti shtohet edhe një nen, nëse nuk i ndërtohet në afat prej 2 ose 3 vite kjo pronë ti kthehet komunës.

Mbledhja ka përfunduar në ora 11:40.

Procesmbajtësi,
Skender Hamza

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E RAHOVECIT - OPSTINA ORAHOVAC
Drejtorja për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
Nr. I prot. 2109
Br. prot. Dt. 17.04 2015
RAHOVEC - ORAHOVAC



Kryesuesi
Nahit Elshani